



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**  
**KRYETARI**

*Adresa Abdi Toptani", nr.1, Tiranë*

*E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al*

Nr.1084 /4 Prot.

Tiranë, më 17 / 12 / 2018

**V E N D I M**

**Nr. 202 , Datë 17.12.2018**

**PËR**  
**AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË**  
**“MINISTRINË E TURIZIMIT DHE MJEDISIT”**  
**për periudhën 01.01.2017 deri 30.8.2018**

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit Tiranë rezultoi që në përgjithësi është vepruar në përputhje me rregullat, kuadrin ligjor dhe dispozitat e tjera që normojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Krahas anëve pozitive u konstatuan dhe të meta e mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe mbylljen e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2017.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154 / 2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**VENDOSA:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar” të ushtruar në “Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit”, sipas programit të auditimit nr. 1084/1, datë 17.09.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 30.08.2018.

**II.** Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## **A. OPINIONI I AUDITIMIT:**

### ***Baza për opinionin:***

KLSH ka audituar pasqyrat financiare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (*Aparati*) për vitin ushtrimor përfunduar më 31 dhjetor 2017, në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” dhe ISSAI 1700<sup>1</sup>, dhe ISSAI 2000<sup>2</sup>.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga MTM dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Menaxhimi i MTM është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe kontrollin e brendshëm, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Audituesit e KLSH-së, nëpërmjet auditimit të realizuar në MTM krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, raportimit financiar (*kriteret e auditimit financiar*) dhe konsistojnë si më poshtë:

### **Opinion:**

Nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualet e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti, është paraqitur në përgjithësi në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Megjithatë, nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardin ISSAI 1700, u konstatuan edhe parregullsi në plotësimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi (të paraqitura më lartë), të konsideruara *jo materiale dhe jo të përhapura*, për të cilën japim ***opinion të pa kualifikuar***<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> ISSAI 1700- Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare është t'i mundësojë audituesit që të shprehë një opinion nëse pasqyrat janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin raportues financiar në fuqi.

<sup>2</sup> ISSAI 2000 – Objektivi i audituesve në një auditim financiar është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

<sup>3</sup> Sipas Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, (kapitulli IV, pika 4.2), “Audituesi duhet të shprehë një opinion të pakualifikuar për besueshmërinë e llogarive kur audituesi arrin në përfundimin që llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që të formojnë atë opinion, ai/ajo duhet të konkludojë se ai/ajo ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit”

## **B. MASA ORGANIZATIVE:**

### **1.-Gjetje nga auditimi:**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ndonëse ka hartuar dokumentacionet, planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që MTM ka në dispozicion, mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës truall në administrim të MTM, (zëri “toka, troje e terrene”).

Në bilancin e periudhës që auditohet, sipërfaqja e përgjithshme prej 2840 m<sup>2</sup> është pasqyruar në kontabilitet me zero lekë.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/A, faqe 9-36 të Raportit të Auditimit.*

### **1.1. Rekomandimi:**

Nëpunësi autorizues të ngrejë një grup pune për identifikuar me planimetri dhe genplane sipërfaqet e tokës truall të MTM dhe pas saktësimit të sipërfaqeve dhe vlerave nga ekspertet e fushës, të ndërmarren veprimet e nevojshme të regjistrimit në kontabilitetin, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

### **2.-Gjetje nga auditimi:**

MTM nuk ka arritur t’i shfrytëzojë të gjitha mjetet nga fondet e trashëguara si grande dhe subvencion, përkatësisht për 14,444 mijë lekë dhe 4,209 mijë lekë, (ose në total prej 18,653 mijë lekë, apo rreth 4 % të të ardhurave gjithsej për vitin 2017 prej 497,447 mijë lekë). Në këtë kohë, në bazë të raporteve të dërguara për ministrinë dhe institucionet e tjera, ka lindur nevoja e rikonsiderimit dhe përdorimit të këtyre shumave. Si rrjedhojë, nuk është arritur të realizohen objektivat lidhur me përdorimin e disa fondeve, pavarësisht faktit se kishte mjete në dispozicion për qëllime të caktuara.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/A, faqe 9-36 të Raportit të Auditimit.*

### **2.1. Rekomandimi:**

Strukturat përgjegjëse të MTM të sigurojnë një menaxhim më efikas të mjeteve nga subvencionet, donacionet dhe grandet, për të siguruar një administrim më eficient të fondeve në dispozicion, në kushtet e risqeve financiare mbi mjaftueshmërinë e fondeve.

*Në vazhdimësi*

### **3.-Gjetje nga auditimi:**

Ndonëse nga ana e MTM është zbatuar detyrimi i pikës nr. 10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe është përgatitur inventari i pronave shtetërore nën përgjegjësinë e tyre administrative, listat e inventarit ende nuk janë dërguar në AITPP për t’iu dërguar për miratim Këshillit të Ministrave.

*Sa më sipër*, nga ana e MTM nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Pronat e MTM, sipas pasqyrimit kontabël në bilancin kontabël të datës 31.12.2017, nuk janë të regjistruara në inventarin e shtetit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe për to nuk zotërohet certifikatë pronësie, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore sa më lartë për regjistrimin e pasurisë shtetërore.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/A, faqe 9-36 të Raportit të Auditimit.*

### **3. Rekomandimi:**

3.1. Menaxhimi i MTM, të ngrejë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e objekteve, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të këtyre pasurive, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm dhe pas saktësimit të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronave që ky dikaster ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore e të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit.

3.2. Të aplikohet pranë AITPP, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura dhe rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve, në zërin “Ndërtesa” për institucionin.

*Brenda 3 muajve*

### **4.-Gjetje nga auditimi:**

Nga Komisioni i Inventarizimit të MTM, i ngritur sipas urdhrorit nr. 18, datë 15.11.2017, të Sekretarit të Përgjithshëm janë nënshkruar rregullisht inventarët e zyrave dhe magazinës në prezencë të personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale, ku janë evidentuar sasitë fizike të mallrave e materialeve dhe gjendjet kontabile, nga ku nuk kanë rezultuar diferenca. Inventarët e zyrave janë nënshkruar rregullisht nga komisioni dhe personat përgjegjës.

Në relacionin e hartuar evidentohet se nuk janë dorëzuar në magazinë

- Laptop me vlerë 206,525 lekë, në ngarkim të ..... dhe

- Laptop me vlerë 206,525 lekë, në ngarkim të ....

Për sa sipër, është vënë shënimi në relacion që “për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimi duhet të funksionojnë komisionet e tjera të cilat ndjekin procedurat e mëtejshme për materialet e grumbulluara”

Nga verifikimet e kryera nga grupi i auditimit të KLSH rezultoi se:

- Nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura për kthimin e në magazinë dhe të bëhen hyrje në magazinë sipas dispozitave ligjore një Laptop me vlerë 206,525 lekë, në ngarkim të znj. ....
- Në librin e debitorëve nuk janë regjistruar detyrimet e mësipërme.

**E gjetura:** MTM e ka formuar Komisionin për inventarizimin e pasurisë i cili e ka kryer inventarizimin dhe ka përgatitur informacionin rreth inventarizimit. Mirëpo nuk ka formuar komisionin për vlerësim të pasurisë, i cili duhet të kryej detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Më konkretisht, nuk është bërë vlerësimi i pasurisë dhe nuk janë zhvilluar procedurat e nxjerrjes nga përdorimi i aktiveve që janë prej vitesh jashtë shfrytëzimit të tyre efektiv dhe procesi ka ngelur i pa përfunduar rregullisht.

**Rreziku:** Mungesa e formimit të komisionit për vlerësim të pasurive dhe mos vlerësimi i tyre e rrisin rrezikun që informacioni i prezantuar në regjistrat e pasurisë të mos përmbushë kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit financiar.

**Konkluzioni** i grupit të auditimit mbi kryerjet e analizimi i rezultateve të inventarizimit të aktiveve dhe nxjerrjes jashtë përdorimit e asgjësimit të tyre, është se ka mangësi e parregullsi në kryerjen e proceduarve të inventarizimit, pasi nuk janë finalizuar me vlerësimin e pasurisë dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të dëmtuara, nuk janë audituar të drejtat e detyrimet dhe aktivet që janë jashtë ambienteve të Ministrisë (godina Durrës, pyjet e përfshira në kontabilitetin e këtij institucioni, etj), në kundërshtim me kërkesat e nenit 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kapitulli V, Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve, Inventarizimi i Aktiveve, pika 74, ku përcaktohet:

*“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të*

*detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”.*

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/A, faqe 9-36 të Raportit të Auditimit.*

#### **4. Rekomandimi:**

**4.1.** Strukturat drejtuese të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit duhet të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionin për vlerësimin e pasurive dhe të procedojnë me nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të dëmtuara, në përputhje me detyrimet e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në mënyrë që të sigurohen informata të drejta dhe të sakta për pasurinë që administrojnë.

**4.2.** Njëpunësi autorizues dhe njëpunësi zbatues të analizojnë rezultatet e grupeve të inventarizimit dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27/12/2011, duke iniciuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuar për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme, në referencë të paragrafit 95 e vazhdim, të Udhëzimit të sipërsëhënuar të Ministrisë së Financave.

**4.3.** Të kërkohet kthimi i laptop-ëve për dy punonjës të ish-Ministrisë së Mjedisit me vlerë nga 206,525 lekë secili, në të kundërt të kontabilizohet detyrimi dhe merren masa për arkëtimin e detyrimeve të mësipërme.

**4.4.** Nga strukturat e menaxhimit të MTM të merren masa që dalja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, duhet të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, për ankand, groposje, vend ndodhjen e groposjes së tyre, djegien etj, shoqëruar me fotot përkatëse, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë*

#### **5.-Gjetje nga auditimi:**

Për periudhën objekt auditimi Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka programuar dhe ka likuiduar shpenzime për dy studio ligjore të kontraktuara nga Avokatura e Shtetit me objekt mbrojtjen e shtetit shqiptar nga paditë e dy shoqërive koncensionare për dëmshpërblim sipas objekt padive drejtuar në arbitrazhet ndërkombëtare, e konkretisht:

**5.A.** PAGESA për studion ligjore të huaj “.....” në shumën totale prej 125,043,264 lekë për mbrojtjen e shtetit Shqiptar në arbitrazhin ndërkombëtar për padinë e shoqërisë “.....” shpk për dëmshpërblim të shumës prej 452,000,000 euro për mosmarrëveshjen e lindur në kontratën koncensionare me objekt “Impianti i mbetjeve të ngurta Kashar”. Nga auditimi konstatohet se, për kryerjen e pagesave ndër vite përfshirë edhe periudhën objekt auditimi është likuiduar në favor të studios ligjore shuma prej 135,073 euro.

**5.B.** PAGESA për studion ligjore “.....” në shumën prej 130,208,858 lekë me objekt mbrojtjen e shtetit shqiptar nga padia e shoqërisë “.....”.

*Konstatim:*

Për këto pagesa, Avokatura e Shtetit nuk ka paraqitur kontratat të lidhura me studiot ligjore por disa pasqyra të cilat nuk mund të konsiderohen dokument justifikues për kryerjen e likuidimeve pjesore.

Mungesa e kontratave të lidhura nga Avokatura e Shtetit dhe të pa kontabilizuara në llogarinë 466 “Kreditorë të tjerë” është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë, pika 61, ku përcaktohet se: “Pagesat ndërmjet njërive publike dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet sistemit të thesarit direkt në llogarinë bankare të përfituesit. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes **në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës**. Për moszbatimin e këtij detyrimi zbatohen sanksionet ligjore të përcaktuara në kontratën e lidhur në mes palëve ose në marrëveshjet përkatëse dypalëshe për të cilat mban përgjegjësi nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i njësisë respektive”.

Veprimet e mësipërme nuk tregojnë për transparencë të shpenzimeve që janë kryer apo do të kryhen në periudhat e ardhshme, si për vlerën e paguar ashtu edhe detyrimin përfundimtar që ka Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ndaj studiove ligjore të përzgjedhura të shpallur fituese dhe kontratës përfundimtare të lidhur nga Avokatura e Shtetit për llogari të kësaj Ministrie. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2/A, faqe 9-36 të Raportit të Auditimit.*

### **5.1. Rekomandimi:**

MMT të marrë masa dhe në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit të rakordojë pagesat e kryera krahasuar me kontratën e lidhur me studiot ligjore që mbrojnë interesat e shtetit (MMT). Për këtë, të kryhet veprimi kontabël për kontratën e lidhur në llogarinë 466 “Kreditorë të tjerë” me objekt detyrimet e mbetura për pagesat e ardhshme, si një veprim transparent, për pagesat që kryen MTM ndaj studiove ligjore të përzgjedhura nga Avokatura e Shtetit.

*Brenda 2 muajve*

### **6.-Gjetje nga auditimi:**

Me urdhër shpenzimin nr. 629, datë 28.12.2017 në shumën prej 2,082,961 lekë janë kryer pagesa për mbulimin e kostos lokale (TVSH) për projektin “**IPA Natura 2000**” në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2017 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)” si dhe nenit 63, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 6, datë 30.11.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” të kontratës nr. 2014/355-174, datë 20.05.2015 “Për forcimin e kapaciteteve kombëtare për ruajtjen e natyrës, përgatitjen e rrjetit natyral 2000” në kuadër të programit IPA 2013.

Nga auditimi për ligjshmërinë e kësaj pagese u konstatua se, midis zërave të “shpenzimeve operative” u gjend fatura nr.1083, datë 02.11.2017 në shumën prej **39,270 euro**, me objekt blerjen e 85 copë biçikleta “BIKE”. Fatura është nënshkruar nga blerësi [.....] dhe njëkohësisht Shefes së Financës së Projektit “IPA”, për të cilën Ministria e Mjedisit ka likuiduar vlerën e TVSH-së në shumën prej **6,545 euro**. Për dokumentimin e kësaj blerje nuk u gjend Fletë - hyrje me qëllim dokumentimin dhe kontabilizimin e biçikletave në aktivet e institucionit në kuadër të këtij programi apo destinacionit përfundimtar të tyre, në zbatim të programit për mbrojtjen e ambientit “Për një shoqëri pa makina”. Mos dokumentimi në aktivet e institucionit apo destinacioni përfundimtar i 85 copë biçikletave, është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 54, “Veprimet që kryejnë strukturat e nëpunësit zbatues”, ku përcaktohet se:

*“Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin*

*justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj."*

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/A, faqe 9-36 të Raportit të Auditimit.*

### **6.1. Rekomandimi:**

Drejtoria e Financës e MTM të marrë masa për të dokumentuar në aktivet e qëndrueshme të 85 copë biçikleta të financuara me fondet e IPA për shume prej 39,270 euro dhe tvsh në shumën prej 6,545 euro, si dhe të kryejë kontabilizimin në llogarinë aktive të qëndrueshme dhe transferimin e tyre nëpërmjet llogarisë 45 "Marrëdhëniet me njësitë vartëse" sipas destinacionit përfundimtar të tyre.

*Menjëherë*

### **7.-Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i likuidimit të shpenzimeve nëpërmjet veprimeve të bankës për periudhën objekt auditimi u konstatua se, situacionet e paraqitura nga shoqëritë e kontraktuara për kryerjen e investimeve apo aktivet të trupëzuara janë nënshkruar edhe nga titullari i institucionit (ministri), veprim i cili kufizon përgjegjësinë në lidhje me ushtrimin e kompetencave të punonjësve para organit që i ka emëruar, sipas nenit 4, pika 9 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 me ndryshimet, ku është përcaktuar se "*.....në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë.*

*Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.*

Po kështu, sipas nenit 4, pika 20, Përgjegjësia e menaxherit (Titullarit të Institucionit) lidhet me ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se, ajo është kryer sipas parashikimit. Nëpërmjet mbikëqyrjes, menaxheri jep udhëzime dhe kryen trajnimin e nevojshëm për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna prej tij kuptohen dhe arrihen nga punonjësit. Duke u ndodhur para një fakti të tillë, pika 9 e nenit 4 të këtij ligji, në disa raste nuk ka gjetur zbatim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/A, faqe 9-36 të Raportit të Auditimit.*

### **7.1. Rekomandimi**

Titullarit të Institucionit, në kuadër të përmbushjes së përgjegjësive menaxheriale, të marrë masat për hartimin, miratimin dhe mirëmbajtjen e kontrolleve dhe procedurave, dhe duke respektuar parimet e kontrollit, të tilla si, *ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se, ajo është kryer sipas parashikimit. Kjo mënyrë veprimi do të bëjë të mundur që funksionet më të larta menaxheriale nëpërmjet mbikëqyrjes të garantojë minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, kjo në zbatim të përcaktimeve të nenit 4, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010.*

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **8.-Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i pasqyrave financiare për investimet e kryera dhe të përfunduara gjatë periudhës objekt auditimi, u konstatua se, me urdhër shpenzimin nr. 622, datë 28.12.2017 është kryer pagesa e fundit për likuidimin e shpenzimeve për investimin e përfunduar me objekt *“Impianti i pastrimit të grykëderdhjes së lumit “Ishëm” dhe rikualifikimi i vijës bregdetare, Kurbin”*, me vlerë të kontraktuar në shumën prej **240,822,540 lekë** me tvsh. Procedura për këtë objekt ka filluar me shkresën e Bashkisë Kurbin, nr. 123/1, datë 11.01.2017, e cila ka paraqitur në Ministri projektin dhe preventivin e plotë të përgatitur nga studio **“.....”** me administrator z.**.....** Sipas këtij projekti, preventivi për hartimin e fondit limit është llogaritur në shumën prej 208,231,441 lekë pa tvsh. Fondi limit sipas urdhrit të prokurimit nr. 7, datë 17.01.2017, është përcaktuar në shumën prej 204,648,941 lekë pa tvsh, ose rreth 3.6 milionë lekë më pak se preventivi i hartuar nga Z.**.....**

Nga verifikimi saktësisë së hartimit të formularit të përcaktimit të fondit limit u konstatua se **nga 24 zëra që ka preventivi, 10 prej tyre nuk kanë referencë çmimi**, në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 *“Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”*. Nga 24 zëra që ka referencë çmimi në manualin analitik të çmimeve të punimeve të ndërtimit, **në dy zëra, konstatohen rritje artificiale të çmimeve**, e konkretisht:

a. Zëri i punimeve *“Gërmim dhe rrugë aksesi”* gjatësi 2 km \* 4ml me h=50 cm me analizë 3.111/b, me volum prej 4,000 m<sup>3</sup>, preventivi për këtë zë i hartuar nga **.....** është llogaritur me çmimin prej 281 lekë/m<sup>3</sup>. Sipas tarifave të miratuara me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 çmimi për këtë zë punimi është 217 lekë/m<sup>3</sup>. Si rrjedhojë e kësaj pasaktësie vlera e preventivit është rritur artificialisht më tepër për vlerën prej 256,000 lekë: {4,000\*(281-217) = 256,000}.

b. Zëri i punimeve *“Gërmim i rërës së vijës bregdetare”* me sip. 25 ha, 50 cm thellësi me analizë 3.111/ b, me volum prej 125,000 m<sup>3</sup>, sipas preventivit të hartuar nga **.....** është llogaritur me çmimin prej 281 lekë/m<sup>3</sup>. Nga verifikimi i kryer në listën e tarifave të çmimeve të përcaktuara në VKM nr. 629, datë 15.07.2015, grupi i auditimit duke marrë për bazë referencën e çmimit të përcaktuar nga preventivuesi, konstaton se referenca e këtij zëri i përket zërit *“gërmim dhe në tokë të zakonshme”*, e cila ka tarifën 217 lekë/m<sup>3</sup>. Në këto kushte, ndonëse kemi të bëjmë me gërmim në rërë të imët e cila ka kosto punimi tepër minimale krahasuar me punimet në tokë të zakonshme. Në këtë rast grupi i auditimit merr për bazë çmimin e gërmimit në tokë të zakonshme me çmim 217 lekë (preventivi ka çmimin 281 lekë, ose +64 lekë më tepër).

Nga sa më sipër, konstatohet se vlera e preventivit të këtij zëri me volum 125,000 m<sup>3</sup> është rritur artificialisht më tepër për vlerën prej 64 lekë m<sup>3</sup> (281-217), e cila ka sjellë si pasojë rritjen e fondit limit në shumën prej 8,000,000 lekë. Konkretisht {124,000\*(281-217)=8,000,000}

**Si përfundim, për këto 2 zëra fondi limit për këtë objekt është rritur artificialisht në vlerën prej 8,256,000 lekë.**

Kështu:

Fondi limit total sipas preventivit të hartuar nga **.....** është llogaritur në vlerën prej 208,231,441 lekë, ndërsa Njësia e Prokurimit ka përcaktuar fondin limit në vlerën prej 204,648,941 lekë pa tvsh. Nga rillogaritja e kryer fondi limit duhej të përcaktohej në vlerën prej 199,975,441 lekë (208,231,441 - 8,256,000). Në përfundim të tenderit është shpallur fituese shoqëria **“.....”** shpk me ofertë në vlerën prej 202,603,181 lekë.

**Përsa më lart, si rrjedhojë e rritjes artificiale të fondit limit në shumën prej 8,256,000 lekë dhe ofertës së paraqitur nga shoqëria **.....** në vlerën prej 202,603,181 lekë, rezulton**



**dëm ekonomik dhe përfitim i padrejtë nga shoqëria “.....” në vlerën prej 3,153,288 lekë me tvsh (202,603,181-199,975,441= 2,627,740 \* 20%)**

Nga auditimi konstatohet se vlera përfundimtare e likuiduar për këtë objekt është kontabilizuar në llogarinë 466 “Debitorë të tjerë” me qëllim transferimi në Bashkinë Kurbin. Nga verifikimi i mëtejshëm për respektimin e kushteve të përcaktuara në kontratë konstatohet se objekti **nuk është marrë në dorëzim, ndonëse ka mbi 10 muaj që ka përfunduar dhe është njoftuar institucioni nga ana e sipërmarrësit. Mos marrja e objektit në dorëzim ndonëse ka kaluar mbi 11 muaj përbën shkak për dëmtimin e objektit dhe rrezikon dëmtime të pakthyeshme në impiantin e grumbullimit të mbeturinave.**

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/A, faqe 9-36 të Raportit të Auditimit.*

### **8.1. Rekomandimi:**

Të merren masa për të arkëtuar vlerën prej **3,153,288 lekë** me tvsh, nga shoqëria “.....”, për sa për fituar padrejtësisht në realizimin punimeve me objekt “*Impianti i pastrimit të grykëderdhjes së lumit “Ishëm” dhe rikualifikimi i vijës bregdetare, Kurbin*”.

*Brenda 3 muajsh*

### **9.-Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi në lidhje më pagesat e kryera me objekt likuidimin e detyrimeve të krijuara nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe dëmshtëpërblimin e punonjësve të pushuar padrejtësisht nga puna për çdo vit programohen dhe planifikohen në artikullin buxhetor 604 “shpenzime operative”, fonde që nuk kanë të bëjnë me shpenzimet operationale të institucionit, por me marrëdhëniet e punës dhe pagat e punonjësve të cilëve gjykata u ka dhënë të drejtën e rikthimit në punë dhe shpërblimin e pagës për aq kohë sa janë larguar padrejtësisht nga puna. *Pra, këtyre punonjësve vitet e larguara nga puna u njihet ligjërisht vjetërsi në punë për efekt pensioni pleqërie si dhe pagesa shtesë mbi pagë për çdo vit pune.*

Me kryerjen e pagesës së plotë kuptohet “**paga bruto**” e llogaritur sipas VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “*Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor*”, i ndryshuar dhe “**kontributi i sigurimeve shoqërore nga punëdhënësi (16.7 %)**” mbi pagën bruto të listëpagesës që ato do të përfitonin nga institucioni (MTM) gjatë kohës që kanë qenë në marrëdhënie pune.

***Mos regjistrimi i këtyre detyrimeve në kontabilitetin e institucionit ku punonjësi ka punuar, për më tepër planifikimi dhe likuidimi i tyre nga artikulli “shpenzime operative” dhe jo nga artikulli buxhetor 600 “Paga” dhe 601 “Sigurime shoqërore”, çojnë në mos derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në institucionet e sigurimeve, për pasojë këtyre punonjësve nuk u njihen për efekt pensioni pleqërie vitet e larguara nga puna.*** Për mosllogaritjen dhe mos kontabilizimin e këtyre pagesave edhe në periudhat e kaluara është lënë rekomandim nga KLSH, por ky rekomandim nuk është marrë në konsideratë, ndonëse këta punonjës janë rikthyer në punë sipas vendimit të gjykatës dhe janë trajtuar me pagën e plotë (paga bruto-tatimin mbi të ardhurat).

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/A, faqe 9-36 të Raportit të Auditimit.*

### **9.1. Rekomandimi:**

Për të gjithë rastet e vendimmarrjeve gjyqësore të formës së prerë, duhen marrë masa nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në MTM që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të programohet fondi për kontributin e sigurimeve shoqërore nga punëdhënësi për sa kohë këta ish punonjës janë larguar padrejtësisht nga puna dhe aktualisht janë rikthyer në marrëdhënie punë pranë institucionit (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit).

*Në vijimësi*

## **10.-Gjetje nga auditimi:**

MTM ka publikuar njoftim në një gazetë ndërkombëtare dhe nuk ka marrë masa për rimbursimin e kësaj shume nga kontraktuesi sipas përcaktimeve në aktet nënligjore, e konkretisht:

Me urdhër Shpenzimin nr. 390, datë 29.08.2017 në shumën prej **955,862 lekë** është likuiduar në favor të gazetës *“The Economist Newspaper Ltd.” Londër* sipas Urdhrit nr. 200, datë 05.06.2017 të ish-Ministrit, për botimin e njoftimit për shpalljen e procedurës konkurruese përzgjedhëse për dhënie me koncension të ndërtimit të landfillit icineratorëve dhe rehabilitimit të vend depozitimeve ekzistuese në Tiranë.

Pagesa i referohet faturës tatimore nr. MM225030, datë 27 maj 2017, lëshuar nga kjo gazetë, sipas kontratës së datës 19 maj 2017, e nënshkruar nga specialisti i prokurimeve të Ministrisë së Mjedisit dhe përfaqësuesi i gazetës. Bashkëlidhur pagesës është dhe njoftimi i publikuar/ botuar në gazetë.

Në pikën 2 të Urdhrit të Ministrit të Mjedisit është përcaktuar se, *“pagesa e botimit në gazetën “The economist” do të mbulohet nga Ministria e Mjedisit” dhe pas shpalljes së fituesit do të rimbursohet në llogari të Thesarit të Shtetit për Ministrinë e Mjedisit”.*

Pas kryerjes së procedurave të përzgjedhjes dhe lidhjes së kontratës së koncensionit, me operatorin ekonomik fitues rezulton se vlera prej **955,862 lekë** nuk është rimbursuar nga ana e operatorit ekonomik në buxhetin e shtetit për llogari të këtij institucioni. Sa më lartë, është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”* për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe shlyerjen e detyrimeve.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/A, faqe 9-36 të Raportit të Auditimit.*

### **10.1. Rekomandimi:**

Te merren masa për vënien në kushtet e arkëtimit/ rimbursimit për llogari të MTM të shumës **955,862 lekë** nga subjekti palë e marrëveshjes së koncesionit, sipas Urdhrit të MM me nr. 200, datë 05.06.2017.

*Brenda 3 muajve*

## **11.-Gjetje nga auditimi:**

Për periudhën objekt auditimi nuk kishte rregullore të miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, pavarësisht se është hartuar një draft rregullore (e miratuar me urdhrin nr. 9034 të Ministrit, datë 07.11.2018). Gjendur në këto kushte Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka kryer aktivitetin e saj duke zbatuar rregulloret e ish ministrive, ish-MM, si dhe ish-ME (për pjesën e turizmit). Pohimi në pyetësinë e vetëvlerësimit me nr. 1580, datë 23.02.2018 për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2017, (pika nr. 8 e pyetësit, komponenti *“Mjedisi i kontrollit”*, nënkomponenti *“strukura organike”*, se *“Detyrat dhe përgjegjësitë e çdo drejtori/ sektori janë të pasqyruara qartësisht në rregulloren e miratuar të ministrive përkatëse, nuk ka raste të mbivendosjes së detyrave dhe përgjegjësiave zyrtare”*, nuk përbën fakt të arsyeshëm dhe të vërtetë në pyetësinë e vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/B, faqe 38-45 të Raportit të Auditimit.*

### **11.1. Rekomandimi:**

Nga ana e MTM Tiranë të rishikohen komponentët e mjedisit të kontrollit dhe në plotësimin e rubrikave të pyetësit të vetëvlerësimit të pasqyrohet situata reale e çdo komponenti dhe nënkomponenti të lidhur me gjendjen e kontrolleve të brendshme për fazën e raportuar.

*Në vijimësi*

## **12.-Gjetje nga auditimi:**

**12.1.** Nga vlerësimi i organizimit dhe efektivitetit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm (KAB) të MTM, konstatohet se, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm*”, ka rezultuar se:

Me urdhrin nr. 107, datë 23.05.2016 të ish-Ministrit të Mjedisit, është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm. Ky komitet ka miratuar Rregulloren e funksionimit, të miratuar me Vendimin e këtij komiteti nr. 1, datë 11.07.2016 si dhe janë kryer takime periodike dhe analiza nga ane KAB mbi aspektet e planifikimit dhe raportimit vjetor të NJAB në MF.

Rezulton se, mbas datës 23 maj 2018, KAB ka përfunduar misionin e tij, në përputhje me pikën nr. 6 të VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm*”, ku cilësohet se, “*Mandati i Komitetit të Auditimit të Brendshëm është 2-vjeçar, me të drejtë riemërimi*”. Pas datës 23 maj 2018, nuk është kompozuar dhe nuk ka funksionuar KAB i MTM. Sipas memo-s së datës 28 gusht 2018, Drejtori i DAB ka dërguar propozimin për riemërim të anëtarëve të KAB dhe deri ditën e mbajtjes së këtij dokumenti nuk ka një qëndrim të titullarit të institucionit.

Me urdhrin Ministrit nr. 361, datë 08.10.2018 është rikompozuar KAB me të njëjtën përbërje.

**12.2.** Mbështetur në të dhënat e raportuara nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm rezulton se *auditimet e kombinuara*, zënë peshën më të madhe të auditimeve të planifikuara për vitin 2018. Kjo mundëson një vlerësim të mirë të veprimtarisë së subjektit duke siguruar lidhjen midis sistemeve.

Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentave themelore të planifikimit të aktivitetit të kësaj Drejtorie, konstatohet se, nuk janë planifikuar auditime në drejtori, fusha apo sistemet të brendshme të Ministrisë (të tilla si, sistemi i lejeve dhe licensimeve të spektrit mjedisor dhe turistik; sistemi i kompozimit, zbatimit dhe monitorimit për partneritetin dhe marrëveshjet koncensionare, sistemi i administrimit dhe qeverisjes së pyjeve, zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit, sistemi i prokurimeve publike, meqenëse i janë nënshtruar auditimeve të kryera nga strukturat e KLSH-së.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/B, faqe 38-45 të Raportit të Auditimit.*

## **12.1. Rekomandimi:**

Nga ana e DAB e MTM duhet të planifikohen angazhimet profesionale në Planin vjetor e strategjik, bazuar në indikatorët e auditimit (*niveli i risqeve, materialiteti individual dhe akumulativ, dobësitë e kontrolleve të evidentuara nga auditimet e mëparshme*), duke prioritetizuar objektet që planifikohen për auditim, të tilla si drejtoritë operacionale të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit etj.

Komiteti i Auditimit të brendshëm të analizojë dhe ndjekë në vijimësi zbatimin e këtij rekomandimi, si në fazën e planifikimit ashtu dhe të raportimit nga ana e DAB së MTM.

*Periodikisht dhe në vijimësi*

## **13.-Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura rezulton se:

✓ Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në rrugë shkresore dhe elektronike me datën 2 shkurt 2018 është dërguar raportimi i detyrimeve të prapambetura për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2017”, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sipas pasqyrës bashkëngjitur shkresës rezulton se, vlera e këtyre detyrimeve të konsoliduara për vitin 2017 rezulton në **253,3 milionë lekë** dhe e përbërë vetëm nga vendimet gjyqësore.

✓ Referuar informacionit të publikuar në web-faqen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, mbi detyrimet e prapambetura deri 31.12.2017 për Ministrinë e Turizmit dhe

Mjedisit rezultojnë detyrimet po për të njëjtën vlerë prej **253,3 milionë** lekë. “Sipas informacionit që shoqëron pasqyrën e detyrimeve të prapambetura për periudhën janar-dhjetor 2017, evidentohet se stoku i detyrimeve të raportuara nga kjo ministri raportohet në vlerën 253,3 milionë lekë. Shuma e këtyre detyrimeve rrjedh tërësisht nga vendimet gjyqësore, do të bëhet objekt i shlyerjes përmes buxhetit të kësaj ministrie gjatë 2018-2019”.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara (ministra + institucionet vartëse), rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2017 është **295,2 milionë lekë**, që sipas llogarive kontabile është si vijon:

- **30,433 mijë lekë** të paraqitura në llogarinë llog. 401-408 furnitorë dhe
- **264,829 mijë lekë** si kreditorë. Nga analiza e aktivitetit të bilancit të konsoliduar rezulton se në llog. 467 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet vetëm për 344 mijë leke.

#### **Konstatim:**

Nga sa sipër, rezulton se vlerat e raportuara si detyrime të pa likuiduara deri më datën 31.12.2017 nuk korrespondojnë me pasqyrat financiare të konsoliduara të MTM për vlerën **41,9 milionë lekë**. Sa sipër, nuk janë zbatuar përcaktimet e UMF nr. 5, datë 27.2.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetur”, i ndryshuar dhe UMF nr 28, datë 18.12.2014, i ndryshuar.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/B, faqe 38-45 të Raportit të Auditimit.*

#### **13.1. Rekomandimi:**

Të merren masat nga ana e strukturave përgjegjëse (Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues) për rakordimin e detyrimeve analitike me llogaritë sintetike të bilancit kontabël të datës 31.12.2018, të evidentohen rregullisht detyrimet e pagueshme dhe të drejtat e arkëtueshme të mbartura nga vitet e kaluara si për Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit ashtu edhe për njësitë vartëse, si dhe programimin e punës për arkëtimin e të drejtave dhe likuidimin e detyrimeve sipas rajoneve ku kanë selinë çdo debitor.

*në vijimësi*

#### **14.-Gjetje nga auditimi:**

Për periudhën objekt auditimi rezulton një kosto e madhe nga efektet e vendimeve gjyqësore, për të cilat nuk është nxjerrë përgjegjësia, në kundërshtim me pikën nr. 62, të UMF nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit të shtetit”, sipas të cilit, “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe **kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative**. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.”

Referuar relacionit të bilancit kontabël 2017, del se, duke marrë në konsideratë vendimet gjyqësore të formës së prerë që janë në pritje për tu likuiduar dhe që paraqiten në pasiv të bilancit 2017, **në total janë 399 raste të vendimmarrjes gjyqësore për largim të padrejtë nga puna, në vlerën totale 377,531 mijë lekë**, nga ku :

- Për 140 punonjës janë kryer likuidime në vlerën 120 milionë lekë dhe;
- Për 259 punonjës janë depozituar vendimet e formës së prerë (nga këto, 243 punonjës vendim për ekzekutim dhe 16 raste me rikthim në punë).

***Për sa sipër, i takon të paguhet rreth 3 persona pothuajse për çdo pozicion të punësuarit në institucion.***

✓ Nuk është zbatuar pika nr. 5, e Udhëzimit të KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, që përcakton se: “*Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar*”.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2/A, faqe 9-36 të Raportit të Auditimit.*

#### **14.1. Rekomandimi:**

Duke marrë shkas nga vlera e madhe e detyrimeve dhe ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore, si për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ashtu dhe për njësitë vartëse, të cilat kanë peshën specifike më të madhe të dëmshpërblimeve nga vendimet e gjykatave, Titullari i Institucionit në respekt të ligjit të menaxhimit financiar, në të ardhmen të analizojë çdo titull ekzekutiv të nxjerrë nga gjykata për largim pa të drejtë nga puna që sjell si pasojë kosto artificiale në shpenzimet buxhetore, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësisë ndaj zyrtarëve përgjegjës të institucionit.

*Në vijimësi*

#### **15.-Gjetje nga auditimi:**

**15.1.** Nga auditimi i likuidimeve të vlerave të kontratës me objekt “*Ndërtimin dhe administrimin e Impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë*”, sipas VKM nr. 907, dt. 17.12.2014 “*Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë*” rezultoi se:

- Me urdhrin e shpenzimit 24, dt. 26.01.2017 është likuiduar vlera prej 53,833,637 lekë në favor të subjektit privat “**.....**” shpk.

Bashkëngjitur Urdhrave të shpenzimit janë këto dokumente:

- Urdhri i pagesës nga Ministri për kryerjen e pagesave për këstet mujore në zbatim të kontratës shoqëruar me shkresat përcjellëse që shoqërojnë situacionet përkatës.
- Kontrata koncensionare me nr. 202 prot., datë 6.1.2015
- Situacioni nr.3, datë 29.2.2016
- Fatura tatimore përkatëse, nr.47, datë 06.01.2017 e lëshuar nga operatori ekonomik dhe që për institucionin janë nënshkruan nga ana e specialistes së financës së kësaj Ministrie.

**15.2.** Nga auditimi i likuidimeve të vlerave të kontratës me objekt “*Ndërtimin dhe administrimin e Impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të qarkut Fier*”, sipas VKM përkatëse :

- Me urdhrin e shpenzimit nr. 24, dt. 26.01.2017 është likuiduar nga MTM vlera prej 62,730,852 lekë në favor të subjektit privat “**.....**” shpk Fier.

Bashkëngjitur Urdhrave të shpenzimit janë këto dokumente:

- Urdhri i pagesës nga Ministri për kryerjen e pagesave për këstet mujore në zbatim të kontratës shoqëruar me shkresat përcjellëse që shoqërojnë situacionet përkatës.
- Aneksi III i Kontratës koncensionare me nr. 555315 prot., datë 24.10.2016
- Fatura tatimore përkatëse, nr. 5, datë 06.11.2017 e lëshuar nga operatori ekonomik dhe që për institucionin janë nënshkruan nga ana e specialistes së financës.

**Konstatohet se:**

1. **Dokumentet shoqëruese një pjesë e tyre janë fotokopje e panoterizuar.**
2. **Për vlerat e punimeve të kryera sipas situacioneve përkatëse nuk ka një raport përmbledhës mbi punimet e kryera deri në periudhën raportuese nga mbikëqyrësit në rastin konkret nga Njësia e Zbatimit të Projektit.**

Sa më lartë, është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj dhe pika 54 “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore.... financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka bashkëlidhur dokumentacioni justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës .....*”

Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 3, “Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, **autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë.....**”.

### **15.1. Rekomandimi:**

Nga MTM, Sektori i Financës të merren masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare:

- Sektori i Financës në mbajtjen e kontabiliteti duhet të mbështet në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues si: *Dokumente bazë justifikuese (faturë blerje/ shitjeje, fletëhyrje/dalje, mandatarkëtim/pagesë), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike dhe shërbejnë për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit; Urdhër shpenzimi që përdoret në marrëdhëniet e subjektit me degën përkatëse të thesarit; libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet;*
- Sektori i Financës për transaksionet që bëhen me fondet buxhetore, duhet të kontrollojë nëse urdhri i shpenzimit ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton shërbimin, marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj.

*Në vijimësi*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**